



Breaking News:

DVP Gjirokaštër – Vihet në pranga 1 shtetas në kërkim

⏏ ⏪ ⏩



17/01/2025

Kamëz – Qëlloi Me Armë Zjarri Pistoletë, Në Ajër, Pas Një Konflikti Të Çastit, Arrestohet 27-Vjeçari

Kamëz

Finalizohet nga Komisarjati i Policisë Nr. 5, operacioni policor i koduar “Moment”.

Qëlloi me armë zjarri pistoletë, në ajër, pas një konflikti të çastit me një shtetas, arrestohet 27-vjeçari.

27-vjeçari, me precedent të mëparshëm penal në fushën e mashtrimit.

Policia gjeti në banesën e 27-vjeçarit dhe sekuestroi armë e zjarrit pistoletë, me municion luftarak.

Shërbimet e Komisarjatit të Policisë Nr. 5, menjëherë pas marrjes së njoftimit se në rrugën “Besëlidhja”, një shtetas kishte qëlluar me armë zjarri, në ajër, kanë organizuar dhe finalizuar operacionin policor të koduar “Moment”, për kapjen e tij.

Si rezultat i veprimeve të shpejta, u kap dhe u arrestua shtetasi F. H., 27 vjeç, banues në Domje, me precedent të mëparshëm penal në fushën e mashtrimit.

Ky shtetas dyshohet se pas një konflikti për motive të dobëta me shtetasin A. H., ka qëlluar me armë zjarri pistoletë, në ajër, dhe më pas është larguar nga vendi i ngjarjes.

Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë, për veprime të mëtejshme.

Kërko

Enter a word for search



Komisariati Dixhital

GET IT ON
Google Play



Download on the
App Store

Arkiva

Select Month ▾

Linqe

- > [Arkiva](#)
- > [Akademia e Sigurisë](#)
- > [Ministria e Brendshme](#)
- > [Agjencia e Mbikëqyrjes Policore](#)
- > [Interpol](#)
- > [Europol](#)
- > [Misioni PAMECA V](#)
- > [SCPA](#)
- > [Projekti Trivalent](#)

◀ Fier – Finalizohet operacioni policor i koduar “Multiple”

DVP Berat – Finalizohet operacioni policor i koduar “Precedenti” ▶